

REPUBLICA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 2785/7 Prot.

Tiranë, më 28.12.2023

Lënda: Lidhur me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ për Shqipërinë *Hysa k. Shqipërisë* "kërkesa nr.52048/16.

SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Adresa: Godina "Poli i Drejtësisë", Rruga Ana Komnena, Tiranë

Në datë 21 shkurt 2023 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) ka publikuar vendimin "Hysa kundër Shqipërisë", kërkesa nr. 52048/16. Vendimi është bërë përfundimtar në datën 21 maj 2023.

Më poshtë ju lutem, gjeni një përmbledhje të fakteve dhe konstatimeve të Gjykatës Evropiane në këtë vendim.

Faktet e çështjes :

Kërkuesja u mbajt në paraburgim me dyshimin se kishte kryer veprën e shpërdorimit të detyrës kur mbante pozicionin e drejtoreshës së Drejtorisë së Kontrollit në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve. Ajo kundërshtoi në rrugë gjyqësore pa sukses paraburgimin e saj para gjykatave vendase. Ajo përfundimisht u shpall fajtoare për vjedhje me shpërdorim detyre në bashkëpunim me të tjerët.

Gjykata Evropiane pas ekzaminimit të çështjes konstatoi shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se gjykatat vendase kishin dështuar për të dhënë arsyet e duhura dhe të mjaftueshme që do të justifikonin privimin e lirisë së kërkueses, sa i përket periudhës së paraburgimit. Referencë specifike në vendim bëhet tek fakti se as Gjykata e Lartë dhe as Gjykata Kushtetuese nuk bënë korrigjimin e këtyre mangësive pasi refuzuan të shqyrtojnë themelin e kërkesës së ankueses.

Konstatime për procedimet në gjykatën e shkallës së parë dhe të Apelit: Gjykata e Rrethit në urdhërimin e paraburgimit të kërkueses ishte referuar rrezikut se kërkuesja do t'i fshihej drejtësisë pa dhënë ndonjë arsytim se përse kishte arritur në konkluzionin se kërkuesja paraqiste një rrezik largimi, ose për të treguar ndonjë rrethanë personale të kërkueses që e kishte çuar atë në këtë përfundim.

Ndërkohë, Gjykata e Apelit, duke hedhur poshtë ankimin e kërkueses kundër masës së sigurisë, ishte mbështetur në thelb në të njëjtin arsyetim si Gjykata e Rrethit, por nuk i ishte referuar faktit që kërkuësja paraqiste rrezik arratisje, por kishte mbajtur qëndrimin se kishte rrezik përsëritje të kryerjes së veprës penale nëse lirohej. Por dhe për këtë qëndrim, ajo nuk kishte shpjeguar se cilët elementë e kishin çuar në arritjen e këtij përfundimi dhe në veçanti, përveç referencës për pasojën dhe dëmin e madh financiar të akuzave nuk ka shpjeguar se çfarë peshë i ka dhënë rekordeve kriminale të mëparshme të kërkueses ose sjelljes së saj. Parashtrimi i kërkueses para gjykatës së apelit se nuk kishte rrezik që ajo të kryente sërish veprën penale pasi ishte pezulluar nga pozita e saj zyrtare meritonte një përgjigje. Ishte e paqartë pse gjykata kishte konsideruar se ajo paraqiste ende rrezikun e kryerjes së një vepre penale, pavarësisht pezullimit të saj nga detyra, në ushtrimin e së cilës ajo ishte akuzuar se kishte kryer veprën në fjalë. Vendimet e të dyja gjykatave ishin bazuar në masë të madhe në pasojat e rënda financiare të veprës konkrete dhe në faktin se kërkuësja dyshohej se e kishte kryer këtë vepër, duke shpërdorur detyrën e saj publike. Megjithatë, këto konsiderata në vlerësim të Gjykatës nuk përbëjnë arsye të pavarura që justifikojnë ndalimin me burg të kërkueses, përveçse në rastet kur ato janë marrë parasysh gjatë vlerësimit të ekzistencës së bazave të lejueshme sipas të cilave mund të caktohet paraburgimi, në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës (referoju § 64 dhe 74 të vendimit).

Së fundi, ndërsa të dyja gjykatat në vendimet e tyre kishin deklaruar se masat alternative të ndalimit të kërkueses në burg ishin konsideruar të pamjaftueshme, në vendimin e gjykatave nuk ka referencë se çfarë peshë i kanë dhënë këto gjykata masave të tjera alternative për të siguruar paraqitjen e kërkueses në gjyq (referoju § 76 i vendimit).

Konstatime lidhur me procesin në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese:

Gjykata Evropiane konstatoi se dhe vendimet e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë nuk adresuan në mënyrë adekuate pretendimet e kërkueses lidhur me ligjshmërinë e masës së paraburgimit dhe kishin mungesë të argumenteve të detajuara në mbështetje të vendimeve të marra.

Ankesa në Gjykatën e Lartë e kërkueses sa i përket masës së sigurisë u shpall e papranueshme *de plano* nga Gjykata e Lartë me arsyetimin se kërkesa nuk është në juridiksionin e saj. Ndërkohë që Gjykata Kushtetuese nuk i shqyrtoi në themel argumentet e kërkueses dhe e rrëzoi ankesën e saj me arsyetimin e vetëm se ajo nuk kishte ishte më në paraburgim, duke qenë se ndalimi i saj ishte zëvendësuar me arrest shtëpiak. Kufizimi i së drejtës së kërkuetit për një vlerësim kushtetues të periudhës së parë të paraburgimit për shkak të mungesës së një interesi legjitim, sipas Gjykatës nuk është specifikash e parashikuar nga ligji i brendshëm, por është identifikuar nga Gjykata Kushtetuese në interpretimin e saj të nenit 134 § 2 të Kushtetutës, i cili parashikon se individët që ankohen në Gjykatën Kushtetuese duhet të argumentojnë lidhur me një interes personal në proces (§ 79 i vendimit).

Në këto rrethana, Gjykata nuk u bind se vendimi i Gjykatës Kushtetuese kishte përcaktuar bindshëm arsyet për të arritur në përfundimin se kërkuësja nuk kishte pasur interes personal për të ankimuar ligjshmërinë e periudhës së saj të parë të paraburgimit. Në veçanti, Gjykata Kushtetuese ishte mbështetur ekskluzivisht te fakti se paraburgimi i kërkueses tashmë ishte ndërprerë. Megjithatë, vendimi i Gjykatës së Rrethit për ta vendosur atë në arrest shtëpiak nuk kishte përfshirë ndonjë përcaktim të ligjshmërisë të periudhës së parë të paraburgimit dhe deri në datën në të cilën Gjykata Kushtetuese miratoi vendimin e saj kërkuësja kishte vuajtur

shëm heqjen e lirisë së saj dhe rrjedhimisht ajo duhet të kishte përfituar në mënyrë legjitime nga rishikimi kushtetues *post facto* i periudhës së saj të parë të paraburgimit, që mund të kishte çuar në konstatimin se ajo ishte ndaluar në kundërshtim me të drejtën e saj për liri, të parashikuar nga neni 5 i Konventës. Përveç interesit moral, një njohje deklarative e shkeljes së të drejtës për liri dhe siguri do të kishte hapur rrugën kërkesës për dëmshpërblim për shkak të paraburgimit të paligjshëm sipas nenit 5.5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (§ 83 i vendimit).

Në këtë kontekst, refuzimi i Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar meritat e ankesës së kërkuarës ka çuar në mos korrigjimin e mangësive në arsyetimin e vendimeve të shkallës së parë dhe apelit dhe nuk ka ndrequr shkeljen e së drejtës së kërkuarës të parashikuar nga neni 5 i Konventës. Ndaj Gjykata del në përfundimin se gjykata vendase kanë dështuar për të ofruar arsye relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar vendimet e tyre për periudhën e parë të ndalimit të kërkuarës (§ 83 dhe 84 i vendimit).

Duke njohur shkeljen GJEDNJ i ka akorduar kërkuarës dhe 4500 euro si shpërblim për dëmin moral dhe 3500 euro për shpenzimet gjyqësore.

Bazuar në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008 (ndryshuar me ligjin Nr. 86/2018), në nenin 19/2, pika 3 të tij parashikohet, se Avokatura e Shtetit përcjell pranë institucioneve, për efekt të zbatimit të njehsuar të praktikës gjyqësore, vendimet e GJEDNJ-së për Shqipërinë, në gjuhën shqipe dhe atë origjinale, pas certifikimit të përkthimit nga Ministria e Drejtësisë.

Në këtë kontekst, lutemi gjeni bashkëlidhur vendimin “Hysa k. Shqipërisë”, kërkesa nr.52048/16, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Në kuadër të nenit 46 të Konventës që parashikon detyrimin e palëve për të marrë masa individuale dhe të përgjithshme për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ, lutemi të mbahet në konsideratë publikimi i vendimit në faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës dhe përfshirjen e tij në kurrikulat e trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës, lidhur me respektimin e nenit 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË ÇËSHTJA HYSA KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 52048/16)

VENDIM

Neni 5 § 3 – Arsyeshmëria e paraburgimit – Mosdhënia e arsyeve të duhura dhe të mjaftueshme nga gjykatat vendëse për të justifikuar paraburgimin e kërkuësës – Të meta në arsyetim të pakorrigjuara me anë të shqyrtimit në kasacion ose shqyrtimit kushtetues, për shkak të refuzimit të Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar dënimin me burg

STRASBURG

21 shkurt 2023

I FORMËS SË PRERË

21.5.2023

Ky vendim është bërë i formës së prerë sipas nenit 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.

Në çështjen Hysa kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *kyetar*,
Georgios A. Serghides,
Yonk Grozev,
Jolien Schukking,
Darian Pavli,
Peeter Roosma,
Ioannis Ktistakis, *gjyqtarë*
dhe Milan Blaško, *Sekretar i Seksionit*,
Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 52048/16) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shtetase shqiptare, znj. Afërdita Hysa (“ankuesja”), më 22 gusht 2016;

vendimin për të njoftuar Qeverinë shqiptare (“Qeveria”) për ankesat sipas nenit 5 §§ 3 dhe 4 të Konventës, në lidhje me mungesën e pretenduar të arsyeve të duhura dhe të mjaftueshme që justifikojnë paraburgimin e kërkuësës, si edhe shqyrtimin nga gjykata vendëse – të pretenduar si jo efektiv – të apeliave të saj për këtë çështje; dhe

vendimin për ta shpallur pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

vërejtjet e palëve;

për kërkesën;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 13 dhjetor 2022 dhe 31 janar 2023;

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e fundit.

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për mungesën e arsyeve të duhura dhe të mjaftueshme për të justifikuar paraburgimin e kërkuësit.

FAKTET

2. Kërkuesja ka lindur në vitin 1968 dhe jeton në Tiranë. Fillimisht, ajo u përfaqësua nga P. Thaçi dhe në vijim nga Z. F. Caka, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

3. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) fillimisht u përfaqësua nga ish-agjenti i saj z. B. Lilo, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

I. PRIVIMI I KËRKUESES NGA LIRIA

4. Në periudhën përkatëse, kërkuesja ishte e punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve dhe mbante pozicionin e drejtoreshës së Drejtorisë së Kontrollit.

A. Periudha e parë e burgimit

1. *Vendim i Gjykatës së Rrethit Tiranë*

5. Mbështetur në një kërkesë të paraqitur nga Prokuroria e Tiranës dhe pas një seance gjyqësore mbajtur në mungesë të kërkueses, në datën 5 nëntor 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë lëshoi urdhrin për paraburgimin e kërkueses me dyshimin se ajo kishte kryer veprën e shpërdorimit të detyrës, në kundërshtim me nenin 248 të Kodit Penal.

6. Gjykata arriti në përfundimin se ishin përmbushur kushtet për dhënien e masës së burgimit parashikuar nga nenet 228 dhe 229 i Kodit të Procedurës Penale (shih paragrafët 29–30 më poshtë). Gjykata konstatoi se kërkuesja ishte pezulluar pasi (gjatë periudhës kur vepronte në pozicionin e saj zyrtar) kishte miratuar rimbursim për një sërë kompanish në vlerën prej 515,455,275 lekësh (LEK – rreth 3.7 milionë euro (EUR) në periudhën konkrete) për taksën e vlerës së shtuar, në shkelje të legjislacionit të zbatueshëm për tatimet.

7. Përveç përshkrimit në detaje të shkeljes së dyshuar të rregullave përkatës për tatimet, gjykata iu referua “rrethanave të kryerjes së shkeljes dhe rrezikun për arratisje të së dyshuarës”.

8. Gjithashtu, gjykata theksoi se:

“Në dhënien e masës së sigurisë së “paraburgimit”, [g]jykata mban në konsideratë veçanërisht pajtueshmërinë e kësaj mase sigurie me kërkesat e çështjes në fjalë. Gjykata e konsideron këtë masë sigurie proporcionale me aspektin se sa të rënda janë faktet dhe dënimin për këtë veprë penale. Vepra e “shpërdorimit të detyrës”, për të cilën Afërdita Hysa është e dyshuar, ka pasur pasojë të rënda për financat e shtetit në shumën prej 515,455,275 lekësh [shqiptarë], [dhe] vlerësohet nga [g]jykata sipas rrezikut që ajo përbën për shoqërinë, qëllimin e saj, pasojat e shkaktuara prej saj, formën [që ka marrë], llojin dhe kohëzgjatjen e dënimit që parashikohet nga ligji [për këtë veprë], si edhe rrethanat rënduese dhe lehtësuese që ekzistojnë në këtë fazë të hetimit.

Duke pasur parasysh këto kushte, [g]jykata vendos të urdhërojë ndalimin e të dyshuarës Afërdita Hysa, pasi vlerëson se çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme.”

9. Më 6 nëntor 2013, kërkuesja u vetëdorëzua tek autoritetet, dhe më 9 nëntor 2013, pas një seance tjetër gjyqësore gjatë së cilës ajo ishte e pranishme, Gjykata e Rrethit Tiranë konfirmoi se përmbusheshin kushtet për paraburgimin e kërkueses. Dosja e çështjes nuk përmban procesverbalin e kësaj seance.

10. Përveç kërkueses, dyshohej se në zhvillimet e përmendura më sipër ishin përfshirë edhe një sërë individësh të tjerë që kishin vepruar privatisht – si edhe katër zyrtarë të tjerë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, në cilësinë e pozicionit të tyre zyrtar.

2. *Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë*

11. Më 15 nëntor 2013, kërkuesja e apeloj vendimin e mësipërm pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Ajo pretendonte se paraburgimi i saj nuk ishte i justifikuar dhe argumentonte se fakti se ajo ishte vetëdorëzuar vullnetarisht në polici tregonte se nuk ekzistonte rreziku se ajo mund të arratisej; për më tepër, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, ajo kishte punuar për autoritetet tatimore, ishte e martuar me një oficer policie dhe ishte nëna e dy fëmijëve të vegjël.

12. Ajo shtonte se ajo nuk ishte në pozitën që të prekte provat pasi ishte pezulluar nga detyra, dhe se, në çdo eventualitet, dosjet konkrete të autoriteteve tatimore ishin sekuestruar nga Prokuroria e Rrethit Tiranë.

13. Në fund, ajo argumentonte se masa e paraburgimit nuk ishte proporcionale me akuzat me të cilat po përballlej ajo, dhe se gjendja e saj e keqe shëndetësore tregonte se një masë sigurie më pak e ashpër do të ishte më e përshtatshme.

14. Më 27 nëntor 2013, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës më të ulët. Gjykata u mbështet kryesisht në të njëjtin arsyetim bërë nga Gjykata e Rrethit Tiranë në lidhje me dyshimin se kërkuesja kishte kryer një vepër penale; megjithatë, ajo nuk iu referua faktit se kërkuesja paraqiste rrezikun për t'u arratisur. Megjithatë, ajo gjykoi si më poshtë:

“Në çështjen konkrete, Gjykata e Apelit..., me qëllim zgjedhjen e masës së duhur të sigurisë e cila do të garantonte ... sigurinë për sa i përket faktit se e dyshuara mund të kryejë të njëjtën vepër penale apo një vepër tjetër më të rëndë, mban në konsideratë sa më poshtë:

- aktet atribuar të dyshuarës konsiderohen të jenë të rënda, referuar dënimit parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal;

- vepra penale në fjalë përbën një rrezik të caktuar ndaj shoqërisë;

- e dyshuara përbën rrezik për shoqërinë, duke pasur në konsideratë rrethanat e kryerjes së veprës për të cilën ajo dyshohet, [dhe] faktin se veprimet janë kryer në emër të institucionit përgjegjës për kontrollin [tatimore] dhe kanë shkaktuar një dëm të konsiderueshëm ekonomik ndaj interesave të shtetit...

Referuar rrethanave, në kundërshtim me atë çfarë pretendohet në ankesën e personit nën hetim, nevojat e sigurisë për çështjen konkrete mund të garantohen vetëm me anë të masës së sigurisë “me burgim”, dhe se çdo masë tjetër është gjykuar me të drejtë si e papërshtatshme.”.

3. Gjykata e Lartë

15. Më 3 dhjetor 2013, kërkuesja paraqiti një rekurs në kasacion (në Gjykatën e Lartë), kryesisht duke iu referuar argumenteve të saj të mëparshëm (shih paragrafët 11–13 më sipër).

16. Më 19 dhjetor 2013, Gjykata e Lartë e pushoi rekursin e kasacionit të kërkueses me katër vota pro dhe një kundër me anë të një vendimi *de plano*, sipas së cilit gjykohej se pretendimet e kërkueses nuk i përkisnin juridiksionit të Gjykatës së Lartë.

4. Gjykata Kushtetuese

17. Më 14 shtator 2015, kërkuesja paraqiti një apelim kushtetues pranë Gjykatës Kushtetuese, me anë të së cilit, për sa ka të bëjë me çështjen konkrete, ajo u mbështet në mënyrë të drejtpërdrejtë në nenin 5 të Konventës, dhe përsërit argumentet e saj të mëparshëm (shih paragrafët 11–13 më sipër).

18. Më 24 shkurt 2016, Gjykata Kushtetuese, me pesë vota pro dhe tre kundër, e rrëzoi ankesën e kërkueses si të papranueshme me arsyetimin se i mungonin argumentet, pasi masa me burgim ndaj saj tashmë ishte zëvendësuar me masën arrest shtëpie në datën 19 qershor 2014 (shih paragrafin 22 më poshtë). Gjykata thekson se kërkuesja nuk kishte interes që të kundërshtonte një masë sigurie të zëvendësuar me një masë tjetër.

19. Një gjyqtar bashkëlidhi një opinion kundërshtues, me anë të së cilit pohonte, midis argumentesh të tjerë, se individët duhet të lejohen të kundërshtojnë kushtetueshmërinë e privimit të tyre të lirisë, edhe nëse, në kohën kur shqyrtohet ky qëndrim kundërshtues, masa e arrestit me burg ndaj tyre mund të jetë zëvendësuar nga një masë më e butë. Ai argumentonte se një individ i mbajtur në burgim në një shkelje të mundshme të Kushtetutës do të vuante paragjykim të konsiderueshëm, që nuk do të reduktohej apo kompensohej me anë të një revokimi të mëpasshëm të asaj mase ndalimi. Së fundmi, duke cituar precedentë të ndryshëm (shih paragrafët 39–41 më poshtë), gjyqtari me anë të opinionit të tij kundërshtues shtonte se Gjykata Kushtetuese, me anë të vendimit për të rrëzuar ankimin, ndahej pa ndonjë arsye të mirë nga praktika gjyqësore e konsoliduar e asaj gjykate. Për këto arsye, ai arrinte në përfundimin se gjykata duhej ta kishte shqyrtuar me Kushtetutën pajtueshmërinë e privimit të kërkueses nga liria, më së shumti për shkak të problematikave *prima facie* që shpalosi çështja.

B. Periudhat e mëpasshme

20. Sakaq, në datën 6 shkurt 2014, kërkuesja paraqiti një kërkesë *habeas corpus*, me anë të së cilës kërkonte që Gjykata e Rrethit Tiranë ta zëvendësonte arrestin e saj me burg me një masë sigurie më të lehtë. Më 11 prill 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi kërkesën.

21. Më 24 prill 2014, kërkuesja paraqiti një tjetër kërkesë *habeas corpus*. Më 13 maj 2014, trupa gjyqesore e Gjykatës së Rrethit Tiranë konstatoi se faza hetimore e procesit gjyqësor kishte përfunduar më 8 maj 2014, kur prokurori kishte kërkuar gjykimin e kërkueses. Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa *habeas corpus* e kërkueses, do të duhej të shqyrtohej nga trupa gjyqesore e Gjykatës së Rrethit përpara së cilës ishte pezull shqyrtimi i çështjes penale për meritat; në vijim ajo e përcolli kërkesën në përputhje me rrethanat.

22. Më 19 qershor 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë e pranoi kërkesën dhe urdhëroi që kërkuesja të kalonte në arrest shtëpie nën mbikëqyrje elektronike.

II. VENDIME MBI MERITAT E AKUZËS PENALE

23. Më 8 tetor 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë e shpalli kërkuesen fajtores për shpërdorim të detyrës kryer në bashkëpunim me persona të tjerë, në kundërshtim me nenet 25 dhe 135 të Kodit Penal. Ajo e dënoi kërkuesen me pesë vite burgim.

24. Më 8 prill 2015, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët; megjithatë ajo urdhëroi që ekzekutimi i vendimit të pezullohej me kushtin që kërkuesja të mos kryente ndonjë veprë tjetër për pesë vjet. Për këtë arsye, kërkuesja u la e lirë.

25. Pas vendimit të Gjykatës së Lartë për të hequr pezullimin e dënimit për kërkuesen, dhe një vendimi të mëpasshëm dhënë nga Gjykata Kushtetuese që e dërgonte çështjen për rigjykim, më 19 shkurt 2018, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë të datës 8 prill 2015.

KUADRI LIGJOR DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE

I. LIGJI VENDËS

A. Kushtetuta

26. Pjesët përkatëse të neneve 27 dhe 28 të Kushtetutës parashikojnë, si më poshtë:

“Neni 27

1. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.

2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:

...

c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

...

Neni 28

1. Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t’i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij.

2. Personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi “c”, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.

3. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundërt një garancie pasurore sipas ligjit.

4. Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t’i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase.

5. Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.”

27. Pjesa përkatëse e nenit 134 § 2 të Kushtetutës parashikon se individët mund të paraqesin një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese vetëm për çështjet që kanë lidhje me interesat e tyre.

B. Ligji për Gjykatën Kushtetuese (ligji nr. 8577, i datës 10 shkurt 2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”)

28. Neni 30 i ligjit për Gjykatën Kushtetuese, në fuqi në periudhën konkrete, parashikonte se afati për dorëzimin e ankesave individuale në Gjykatën Kushtetuese ishte dy vjet.

C. Kodi i Procedurës Penale (“KPP”)

29. Sipas nenit 228 § 1 të KPP-së, në fuqi në periudhën konkrete, një masë sigurimi personal do të vendosej nëse, sipas të dhënave, ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se një i pandehur kishte kryer një krim. Sipas nenit 228 § 2, nuk mund të vendoset asnjë masë sigurimi personal kur ka shkaqe sipas së cilave individ mund të mos dënohet, ose nëse vepra bëhet e pandjekshme penalisht. Sipas nenit 228 § 3, masat e sigurimit vendosen, kur: a) ekzistojnë arsye të rëndësishme të cilat do të vinin në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; b) i pandehuri i është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) ekziston rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit, mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtut lloj me atë për të cilin procedohet.

30. Sipas nenit 229 § 1 të KPP-së, për dhënien e masës së sigurimit personal, një gjykatë mban në konsideratë përshtatshmërinë e saj dhe masën e nevojshme të sigurisë, për çështjen konkrete. Sipas nenit 229 § 2 të KPP-së, gjykata duhet të mbajë në konsideratë edhe rëndësinë e akteve që i atribuohen të dyshuarit, masën e dënimit të parashikuar, çdo tendencë të personit të dyshuar për të kryer përsëri një vepër penale (nëse ai ose ajo është dënuar për krime të mëparshme), dhe çdo rrethanë lehtësuese dhe rënduese.

31. Neni 230 § 1 i KPP-së parashikon se arresti me burg mund të vendoset nëse asnjë masë tjetër nuk është e përshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës konkrete dhe të pandehurit. Neni 230 § 2 parashikon se arresti me burg nuk mund të vendoset ndaj një gruaje që është shtatzënë ose një gruaje që ushqen me gjë, ndaj një personi që vuan nga një situatë veçanërisht e rëndë shëndetësore, si edhe në një sërë rastesh të tjera.

32. Sipas nenit 232 të KPP-së, një gjykatë mund të urdhërojë masat e mëposhtme kufizuese: ndalimi i daljes jashtë shtetit; detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore; ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar; garancia pasurore; d) arresti në shtëpi; arresti në burg; shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik.

33. Sipas nenit 240 të KPP-së, një gjykatë mund të urdhërojë masat e mëposhtme ndaluese të sigurimit personal: pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik; ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste.

34. Neni 268 § 2 i KPP-së parashikon se individët të cilët që kanë qenë të paraburgosur, kur me vendim të formës së prerë vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa është nxjerrë pa qenë kushtet e parashikuara nga nenet 228 dhe 229, kanë të drejtën të kompensohen për paraburgimin e vuajtur.

D. Kodi Penal

35. Neni 135 i Kodit Penal parashikon veprën e “vjedhjes së kryer duke shpërdoruar detyrën”.

36. Neni 248 i Kodit Penal parashikon veprën e “shpërdorimit të detyrës”.

E. Kompensim për dënimin penal të padrejtë (ligji nr. 9381 i datës 28 prill 2005)

37. Nenet 2 dhe 3(ç) të ligjit parashikojnë të drejtën e një individ për kompensim për vuajtjen e paraburgimit të paligjshëm në të njëjtat kushte si ato të parashikuara në nenin 268 § 2 të KPP-së (shih paragrafin 34 më sipër). Sipas nenit 8(3) të ligjit, pretendimi për kompensim duhet të dorëzohet pranë gjykatës përkatëse të shkallës së parë.

II. PRAKTIKA GJYQËSORE VENDËSE

A. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë në lidhje me masat e arrestit

38. Në vendimin nr. 7 të datës 14 tetor 2011, Gjykata e Lartë, e mbledhur në një formacion plenar (Kolegjet e Bashkuara) pranoi, për sa ka të bëjë me çështjen, se:

“9. ... ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm mbështetur në prova ndaj të pandehurit (*fumus delicti*) është vetëm kushti fillestar, [ose] parakushti, për zbatimin e masës së sigurimit personal. Ky kusht [ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm] nuk përjashton – përkundrazi, ai nënkupton – se përveç kësaj [këtij dyshimi], është e nevojshme të provohet të paktën njëri prej kushteve dhe

kritereve të tjera ligjore, të cilat bëjnë fjalë për një masë sigurimi personal, si edhe për përshtatshmërinë e masës aktuale të sigurimit [që do të vendoset për të] kufizuar lirinë e të pandehurit (*periculum libertatis*). Procesi gjyqësor që vendos ose shqyrton nevojën për një masë sigurimi, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji, mbështetet dhe ka për qëllim të arrijë balancën e nevojshme midis, nga njëra anë, respektit për (dhe mbrojtjen e) rendit publik dhe ... administrimin e drejtësisë, dhe, nga ana tjetër, të drejtat dhe interesat ligjorë të individit që i nënshtrohet procesit gjyqësor – ku që të dyja parashikohen në Kushtetutë.

...
Sipas interpretimit korrekt të kuptimit që i duhet dhënë termit “rrezik”, sipas nenit 228 [të KPP] në tërësi – duke përfshirë paragrafin (a) të atij neni – gjykata arrin në përfundimin e unifikuar se në çdo fazë të procesit gjyqësor, kërkesa e paraqitur nga prokuroria dhe vendimi i gjykatës me anë të së cilit vendoset masa e sigurimit personal duhet të arsyetohen [në mënyrën e duhur], ..., dhe [duhet] të përcaktojnë (konkretisht) nevojën për një masë sigurimi personal dhe [të detajojnë] arsyet e rëndësishme në lidhje me “rrezikun” [konkret] – që do të thotë, probabilitetin [ose] mundësinë reale që procesi gjyqësor (*plerumque accidit*) do të rrezikohet nga i pandehuri.”.

B. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese për paraburgimin

39. Në vendimin nr. 28, të datës 23 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi një grup ankesash ndaj vendimit gjyqësor me anë të së cilit urdhërohej arrestimi i ankueses. Gjykata Kushtetuese theksonte se vendosja e një mase sigurimi kishte të bënte në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut për personin e prekur – që do të thotë me lirinë personale të një individi. Gjithashtu, gjykata citonte praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut sipas nenit 5 të Konventës. Pas zbatimit të parimeve të zbatueshme për çështjen konkrete Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankimet.

40. Në vendimin nr. 40, të datës 18 korrik 2012, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi një ankesë ku thuhej se Gjykata e Apelit Tiranë kishte gabuar në përllogaritjen e afatit për të apeluar kundër një vendimi të gjykatës së shkallës së parë, me anë të së cilit urdhërohej arrestimi i ankuesit. Gjykata Kushtetuese konstatoi se ankimi ishte i pranueshëm, pavarësisht faktit, se: i. në grupin vijues të procedurave, gjykatat e zakonshme kishin zëvendësuar paraburgimin e kërkuesit me arrest në arrest shtëpie; dhe ii. më pas ai ishte arrestuar mbështetur në fuqinë e një vendimi që vendoste dënimin me burgim.

41. Për sa ka të bëjë me meritat e çështjes përpara saj, gjykata shqyrtoi aspektin nëse procesi që çoi në paraburgimin e kërkuesit kishte zbatuar kërkesat për “një seancë të drejtë”, sipas Kushtetutës. Pas atij shqyrtimi, gjykata e mbështeti ankesën, duke gjykuar se ishte shkelur e drejta e kërkueses për t’iu drejtuar gjykatës së apelit për të kundërshtuar paraburgimin dhënë nga gjykata e shkallës së parë, për shkak të keqzbatimit të ligjit përkatës. Megjithatë, duke pasur parasysh se procesi i paraburgimit ishte bërë i dyshimtë, Gjykata Kushtetuese nuk urdhëroi rigjykim përpara gjykatave të zakonshme.

LIGJI

42. Në mbështetje të nenit 5 § 1 (c) të Kushtetutës, kërkuesja u ankua se vendimet vendëse që urdhëronin burgimin e saj nuk përmbanin arsyetimin e duhur dhe të mjaftueshëm, dhe as nuk u referoheshin rrethanave të saj personale. Sipas nenit 5 § 4 të Konventës, ajo u ankua edhe se apelimet e saj, në lidhje me arrestimin e saj nuk ishin shqyrtuar në mënyrën e duhur. Gjykata, duke qenë kompetente në karakterizimin e fakteve të çështjes sipas ligjit, gjykon se këto ankesa duhet të shqyrtohen sipas nenit 5 § 3 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t’u paraqitur në procesin gjyqësor.”.

I. ZBATIM I NENIT 37 § 1 (b) TË KONVENTËS

43. Qeveria parashitroi se më 19 qershor 2014, gjykatat vendëse kishin zëvendësuar paraburgimin e kërkueses me arrest shtëpie (shih paragrafin 22 më sipër), dhe se më 8 prill 2015,

ajo ishte lënë e lirë (shih paragrafin 24 më sipër). Në këtë mënyrë, sipas këndvështrimit të Qeverisë çështja ishte zgjidhur dhe duhet të çregjistrohet nga lista e çështjeve të Gjykatës në mbështetje të nenit 37 § 1 (b) të Konventës.

44. Kërkuesja mbështeti ankesat e saj pa e adresuar këtë çështje.

45. Gjykata vëren se pjesa e ankesave të kërkueses që tashmë janë përpara saj lidhen me periudhën e parë të burgimit të saj, që zgjati pesë muaj dhe pesë ditë. Ajo periudhë filloi më 6 nëntor 2013, kur ajo u dënua me burgim sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, të datës 5 nëntor 2013 (shih paragrafin 9 më sipër). Periudha e burgimit përfundoi më 11 prill 2014, kur gjykatat vendëse e rrëzuan kërkesën e saj *habeas corpus* (shih paragrafin 20 më sipër), duke shkaktuar në këtë mënyrë periudhën e dytë të burgimit të kërkueses, për të cilën ankimet e saj tashmë janë deklaruar të papranueshme.

46. Në vijim, Gjykata vëren se as vendimi vendës i datës 19 qershor 2014 që e vendoste kërkuesen në arrest shtëpie (shih paragrafin 22 më sipër) dhe as vendimi i datës 8 prill 2015 që pezullonte dënimin e saj me burgim (shih paragrafin 24 më sipër), nuk përfshinte ndonjë përcaktim për pajtueshmërinë e paraburgimit fillestar të kërkueses me nenin 5 § 3 të Konventës – një problematikë që shtrihet në zemër të çështjes së saj përpara Gjykatës. Përkundrazi, të gjithë apelimet vendëse, në lidhje me periudhën e parë të burgimit të kërkueses u rrëzuan nga gjykatat vendëse.

47. Ndërprerja e mëpasshme e paraburgimit të kërkueses nuk e ndryshonte faktin se ajo, sidoqoftë, kishte qenë në burgim për pesë muaj e pesë ditë. Për këtë arsye, ajo ka të drejtën të ankohet në Gjykatë se burgimi i saj ishte në kundërshtim me nenin 5 § 3 të Konventës. Më tej, ajo vijon se ndryshe nga parashtrimi i Qeverisë, çështja nuk është zgjidhur dhe nuk janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 37 § 1 (b) të Konventës.

48. Në këtë mënyrë, Gjykata rrëzon kërkesën e Qeverisë që kërkesa të çregjistrohet nga lista e saj e çështjeve.

II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 5 § 3 TË KONVENTËS

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

49. Qeveria iu referua nenit 34 të Konventës, duke kundërshtuar se në datën kur ishte paraqitur kërkesa, kërkuesja nuk ishte e privuar nga liria; për këtë arsye ajo nuk kishte pasur statusin e viktimës, dhe kështu, nuk kishte të drejtë të paraqiste një ankesë pranë Gjykatës.

50. Gjithashtu, Qeveria kundërshtoi se ankesat nuk ishin të mbështetura në fakte.

51. Kërkuesja përsëriti ankesat e saj, pa iu përgjigjur argumenteve të mësipërme.

2. Vlerësimi i Gjykatës

52. Gjykata përsërit se fjala “viktimë”, sipas kontekstit të nenit 34 të Konventës, përcakton personin që preket drejtpërdrejtë nga veprimi ose mosveprimi konkret. Rrjedhimisht, një vendim apo masë në favor të kërkuesit në parim nuk është mjaftueshëm për ta privuar atë nga statusi i tij si “viktimë”, nëse autoritetet vendëse nuk kanë pranuar, shprehimisht ose në thelb, duke korigjuar më pas, shkeljen konkrete të Konventës (shih, midis autoritetesh të tjera, *Sakbnonskij kundër Rusisë* [DHM], nr. 21272/03, § 67, 2 nëntor 2010). Natyra ndihmëse e mekanizmit mbrojtës së Konventës përjashton shqyrtimin e një kërkesë vetëm kur përmbushen këto kushte (shih *Arat kundër Turqisë*, nr. 10309/03, § 46, 10 nëntor 2009). Humbja e pretenduar e statusit “viktimë” të kërkueses përfshin shqyrtimin e natyrës të së drejtës konkrete, arsyet e paraqitura nga autoritetet vendëse në vendimin e tyre dhe vijimësinë e pasojave negative për kërkuesen pas vendimit (shih *Freimanis dhe Lādums kundër Letonisë*, nr. 73443/01 dhe 74860/01, § 68, 9 shkurt 2006).

53. Duke u kthyer te çështja konkrete, Gjykata vëren se kundërshtimi i Qeverisë, në thelb mbështetet tek të njëjtat argumente të paraqitura në kërkesën e saj sipas nenit 37 § 1 (b) të Konventës, duke kërkuar që çështja të çregjistrohet nga lista e çështjeve të Gjykatës (shih paragrafin 43 më sipër). Në këto rrethana, për të njëjtat arsye si ato të paraqitura në paragrafët 45–47 më sipër, Gjykata e rrëzon kundërshtimin e Qeverisë, në lidhje me statusin “viktimë” të

kërkueses në mbështetje të nenit 34 të Konventës (shih, *mutatis mutandis*, *Nada kundër Zvicrës*, [DHM], nr. 10593/08, § 129, GJEDNJ 2012).

54. Së fundmi, në çështjen *Delijorgji kundër Shqipërisë* (nr. 6858/11, § 59, 28 prill 2015) Gjykata konstatoi se Qeveria nuk kishte cituar ndonjë vendim për të mbështetur pretendimin e saj se Gjykata Kushtetuese ofroi një zgjidhje efektive në respektim të së drejtës individuale për liri, garantuar në nenin 5 të Konventës. Megjithatë, në çështjen konkrete, Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi ndonjë problematikë *ratione materiae* tek ankimi, në lidhje me të drejtën për liri, që ishte paraqitur përpara gjykatës nga kërkuesja. Përkundrazi, gjykata bëri një shqyrtim paraprak dhe konstatoi se paraburgimi i kërkueses kishte përfunduar (shih paragrafin 18 më sipër). Gjithashtu, nga praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 39–41 më sipër) mund të vihet re se në të shkuarën, gjykata ka pranuar dhe ka gjykuar ankime me anë të të cilave pretendohet se kishte pasur privim të paligjshëm të lirisë. Për më tepër, Qeveria nuk bëri ndonjë parashtrim se ankimi kushtetues i kërkueses nuk duhet të konsiderohet si një ankim që përbën një zgjidhje efektive, sipas qëllimeve të afatit gjashtëmujor. Për sa më sipër, Gjykata është e mendimit se kërkesa u paraqit brenda afatit gjashtëmujor.

55. Gjykata thekson se ankesat nuk janë as të pambështetura në fakte dhe as të papranueshme sipas shkaqeve të listuara në nenin 35 të Konventës. Për këtë arsye, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

56. Kërkuesja parashtrroi se në urdhrin për arrestimin e saj, vendimet vendëse të datës 5 nëntor 2013 dhe 27 nëntor 2013 nuk kishin cituar arsyet e duhura dhe të mjaftueshme dhe nuk i ishin referuar rrethanave të saj personale. Ajo shtoi se ankimet e saj ndaj arrestimit të saj nuk ishin shqyrtuar plotësisht.

57. Qeveria i kundërshtoi këto argumente. Ajo parashtrroi se secili prej vendimeve vendëse kishte dhënë në mënyrë të detajuar arsyet se përse kërkuesja ishte e dyshuar për veprën për të cilën ishte akuzuar.

58. Në vijim, Qeveria parashtrroi se gjykatat vendëse kishin bërë një vlerësim të detajuar të faktorëve përkatës për nivelin e rrezikut që kërkuesja t'i fshihej drejtësisë dhe të kryente përsëri një shkelje. Në të njëjtën kohë, Qeveria deklaroi se duke qenë se kërkuesja ishte vetëdorëzuar përpara autoriteteve, në dhënien e urdhrin për burgimin e saj, gjykatat vendëse nuk i ishin referuar rrezikut që kërkuesja mund të arratisëj.

59. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, gjykatat vendëse kishin marrë në konsideratë faktin se kërkuesja dyshohej se kishte shpërdorur pozitat e saj dhe ndikimin e saj ndaj zyrtarëve të tjerë publik. Për këtë arsye, sipas Qeverisë, kishte pasur mjaftueshëm elemente që tregonin për një rrezik se nëse nuk mbahej në arrest në burg, kërkuesja do të ndikonte mbi dëshmitarët dhe bashkë-të-dyshuarit e tjerë me të.

60. Në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, Qeveria parashtrroi se mbështetur në karakteristikat specifike të asaj gjykate, ishte normale që kushtet e pranueshmërisë, në lidhje me ankimet paraqitur përpara saj ishin më strikte dhe përfshinin një kërkesë, sipas së cilës kërkuesja duhej të justifikonte se ajo kishte një interes ligjor në paraqitjen e ankimit (shih paragrafin 27 më sipër). Sipas këndvështrimit të Qeverisë, Gjykata Kushtetuese e kishte vlerësuar këtë kërkesë në të njëjtën mënyrë që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerësonte nëse një kërkues kishte “statusin e viktimës”, sipas nenit 34 të Konventës. Në çështjen konkrete, sipas Qeverisë, kërkuesja nuk e kishte përmbushur atë kusht, pasi në kohën kur ishte shqyrtuar ankimi i saj kushtetues, ajo kishte kaluar në arrest shtëpie; për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese kishte vepruar në mënyrë korrekte duke kundërshtuar ankimin e saj.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

61. Parimet e përgjithshme të zbatueshme në lidhje me justifikimin dhe kohëzgjatjen e paraburgimit përcaktohen në vendimin *Buzădj kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], nr. 23755/07, §§ 87–91, 5 korrik 2016.

62. Gjykata përsërit veçanërisht se, teksa paragrafi 1 (c) i nenit 5 parashikon arsyet mbi të cilat paraburgimi mund të jetë i lejueshëm në radhë të parë (shih *De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Holandës*, 22 maj 1984, § 44, seria A nr. 77); paragrafi 3, që krijon të tërën së bashku me përcaktimin e mëparshëm, parashikon garanci të caktuara procedurale, duke përfshirë rregullin se gjykimi pezull për burgimin nuk duhet të tejkalojë afatin e arsyeshëm, duke rregulluar në këtë mënyrë kohëzgjatjen e tij (shih *Buzadji*, cituar më sipër, §§ 86).

63. Sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës mbështetur në nenin 5 § 3, vijimi i një dyshimi të arsyeshëm është kusht *sinè qua non* për vlefshmërinë e paraburgimit, por pasi ka kaluar një kohë e caktuar – që do të thotë që prej vendimit të parë gjyqësor që urdhëron arrestin me burg (shih *Buzadji*, cituar më sipër, § 102) – ai nuk është më i mjaftueshëm. Atëherë, Gjykata duhet të vendosë: 1. nëse arsye të tjera cituar nga autoritetet gjyqësore vijnë të justifikojnë privimin e lirisë; dhe 2. në rastet kur këto arsye ishin “të duhurat” dhe “të mjaftueshme”, nëse autoritetet vendëse kanë shfaqur “kujdes të veçantë” në realizimin e procesit. Justifikimi për çfarëdo periudhe burgimi, pavarësisht se sa e shkurtër ka qenë kjo periudhë burgimi, duhet të demonstron në mënyrë bindëse nga autoritetet (shih, midis shumë autoritetesh të tjerë, *Idalov kundër Rusisë* [DHM], nr. 5826/03, § 140, 22 maj 2012; dhe *Buzadji*, cituar më sipër, § 87).

64. Justifikimet që janë vlerësuar arsye “të duhura” dhe “të mjaftueshme” – përveç ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm – në praktikën gjyqësore të Gjykatës kanë përfshirë arsye të tilla si rreziku për t’u arratisur, rreziku i presionit ndaj dëshmitarëve ose rreziku i ndërhyrjes në prova, rreziku për marrëveshje të fshehta, rreziku për të kryer përsëri vepra penale, rreziku për të prishur rendin publik dhe nevoja për të mbrojtur personin e burgosur (ibid., § 88, me referenca të tjera).

65. Deri në dhënien e dënimit, një i pandehur duhet të konsiderohet i pafajshëm dhe qëllimi i përcaktimit konkret, kryesisht, është të kërkojë lirinë e tij ose të saj paraprak menjëherë pasi burgimi i tij ose saj nuk është më i arsyeshëm (shih, *McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 543/03, § 41, GJEDNJ 2006-X, dhe *Buzadji*, cituar më sipër, § 89).

66. Çështja nëse një periudhë e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte. Aspekti nëse është e arsyeshme që një i pandehur të qëndrojë në burg duhet të vlerësohet mbi faktet e secilës çështje dhe sipas tipareve të saj specifike. Vijimësia e burgimit mund të justifikohet në një çështje të caktuar vetëm nëse ka tregues specifik për një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale parashikuar në nenin 5 të Konventës (shih për shembull, *Labita kundër Italisë* [DHM], nr. 26772/95, § 152, GJEDNJ 2000-IV, dhe *Kudła kundër Polonisë* [DHM], nr. 30210/96, §§ 110 *et seq.*, GJEDNJ 2000 XI; shih edhe *Buzadji*, cituar më sipër, § 90).

67. Në radhë të parë u takon autoriteteve gjyqësore vendëse të garantojnë, se në çdo çështje, paraburgimi i një të pandehuri nuk tejkalon afatin e arsyeshëm. Sipas rastit, duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë, ata duhet të shqyrtojnë të gjitha faktet pro ose kundër ekzistencës së kërkesës përmendur më sipër të interesit publik ose që justifikojnë shmangien e nenit 5, dhe më pas duhet t’i përfshijnë ato në vendimet e tyre për kërkesat për lirim (shih *Buzadji*, cituar më sipër, § 91). Me konsideratë të veçantë ndaj rrezikut, se nëse lirohet, i dyshuari do të kryej përsëri një vepër penale, duhet t’i kushtohet vëmendje, *inter alia*, natyrës dhe rëndësisë së akuzave ndaj të pandehurit, të dhënat e tij ose të saj penale dhe karakteri ose sjellja e tij apo e saj, që do të tregonin se ai ose ajo e paraqiste një rrezik të tillë (shih, për shembull, *Merčep kundër Kroacisë*, nr. 12301/12, § 96, 26 prill 2016; *Šoš kundër Kroacisë*, nr. 26211/13, § 95, 1 dhjetor 2015; dhe *Magnitskiy dhe të Tjerët kundër Rusisë*, nr. 32631/09 dhe 53799/12, § 221, 27 gusht 2019).

68. Në ushtrimin e funksionit të saj në këtë pikë, Gjykata duhet të garantojë se argumentet e gjykatave vendëse në favor të dhe kundër liritimit nuk duhet të jenë “të përgjithshme dhe abstrakte” (shih, për shembull, *Smirnova kundër Rusisë*, nr. 46133/99 dhe 48183/99, § 63, GJEDNJ 2003-IX (ekstrakte)), por përmbajnë referenca për fakte specifike dhe rrethana personale duke justifikuar paraburgimin e një kërkuar (shih, *mutatis mutandis*, *Panchenko kundër Rusisë*, nr. 45100/98, § 107, 8 shkurt 2005).

69. Në rastin kur rrethanat që mund të çonin në arrestimin me burg të një personi mund të ekzistojnë, por nuk përmendeshin në vendimin e gjykatave vendëse, nuk është detyrë e Gjykatës

t'i përcaktojë ato dhe të marrë vendin e autoriteteve vendëse, të cilat kanë vendosur për paraburgimin e kërkuesit (shih *Bykov kundër Rusisë* [DHM], nr. 4378/02, §§ 66, 10 mars 2009, dhe *Georgi Nikolaishvili kundër Gjeorgjisë*, nr. 37048/04, § 77, 13 janar 2009).

b) Zbatimi i tyre parimeve

i. Proceset përpara gjykatave të rrethit dhe të apelit

70. Kërkuesja nuk e kundërshtoi konstatimin se në periudhën konkrete ekzistonte një dyshim i arsyeshëm se ajo kishte kryer një vepër penale. Gjykata nuk ka arsye që të gjykojë ndryshe. Sipas rastit, çështja e diskutueshme është nëse, në caktimin e një dyshimi të arsyeshëm, gjykatat vendëse shtuan arsyet e duhura dhe të mjaftueshme për të mbështetur vendimet e tyre për të mbajtur në arrest me burg kërkuesen (shih paragrafin 63 më sipër).

71. Në lidhje me këtë aspekt, vendimi i datës 5 nëntor 2013 i Gjykatës së Rrethit Tiranë i referohej rrezikut se kërkuesja do t'i fshihej drejtësisë (shih paragrafin 7 më sipër), që është një nga arsyet e lejueshme për të urdhëruar arrestin me burg. Megjithatë, siç u parashtrua nga Qeveria, Gjykata e Rrethit Tiranë nuk kishte paraqitur ndonjë arsye se përse ishte e mendimit se kërkuesja paraqiste rrezikun për t'u larguar. Gjithashtu, sipas kërkesave të praktikës gjyqësore të Gjykatës, ajo nuk përcaktonte as ndonjë rrethanë personale të kërkueses që e çonin gjykatën në përfundimin se ajo ishte një rrezik për t'u arratisur (ibid.).

72. Vendimi i mëpasshëm i Gjykatës së Rrethit Tiranë i datës 27 nëntor 2013 nuk përmbante ndonjë referencë për faktin se kërkuesja pretendonte të paraqiste rrezikun për t'u arratisur. Në këto rrethana, Gjykata e Rrethit Tiranë gjykonte se ekzistonte rreziku se nëse lihej e lirë, kërkuesja do të kryente përsëri një vepër penale. Edhe rreziku për të kryer përsëri një vepër penale përbën arsye për të vijuar dënimin me burgim (shih paragrafin 64 më sipër). Megjithatë, edhe gjykata e apelit mbeti vetëm me deklarimin se ekzistonte një rrezik pa shpjeguar se çfarë elementesh e kishin çuar në arritjen e atij konkluzioni (shih paragrafin 14 më sipër). Veçanërisht, përveç referencës për rëndësinë e akuzave, gjykata nuk shpjegonte se çfarë peshe i jepte, për shembull, të dhënave kriminale të mëparshme të kërkueses, nëse kishte ndonjë të tillë, dhe karakterit apo sjelljes së saj (shih paragrafin 67 më sipër).

73. Në lidhje me këtë aspekt, kërkuesja parashtrroi se nuk kishte ekzistuar asnjë rrezik që ajo të kryente përsëri një vepër penale, pasi ndërkohë ajo ishte pezulluar nga pozicioni i saj zyrtar (shih paragrafin 12 më sipër). Gjykata mendon se një parashtrim i tillë kërkon një përgjigje. Veçanërisht, është e paqartë se përse Gjykata e Rrethit Tiranë gjykonte se kërkuesja ende paraqiste një rrezik për të kryer përsëri një vepër, edhe pse ajo ishte pezulluar nga detyra në ushtrimin e së cilës ajo ishte akuzuar se kishte kryer veprën konkrete.

74. Gjykata vëren se vendimet vendëse të datave 5 dhe 27 nëntor 2013 mbështeteshin kryesisht në pasojat e rënda financiare të veprës konkrete dhe në faktin se kërkuesja dyshohej se e kishte kryer këtë vepër, duke shpërdorur detyrën e saj publike (shih paragrafët 5–14 më sipër). Megjithatë, rëndësia e veprës apo pasojat e saj nuk përbëjnë arsye të pavarura që justifikojnë burgimin dhe të vetme ato mund të mos justifikojnë privimin e një të dyshuari nga liria e tij apo e saj, në rast se nuk konsiderohet vlerësimi i ekzistencës së arsyeve të lejueshme me anë të të cilave mund të urdhërohet burgimi, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës (shih paragrafin 64 më sipër).

75. Qeveria parashtrroi se paraburgimi i kërkueses ishte justifikuar me rrezikun që ajo do të bënte presion ndaj dëshmitarëve ose do të bashkëpunonte me të bashkëpandehurit. Megjithatë, Gjykata vëren se gjykatat vendëse nuk i referoheshin një rreziku të tillë në vendimet e tyre të datave 5 dhe 27 nëntor 2013 (shih paragrafët 5–14 më sipër). Në këtë mënyrë, nuk i takon Gjykatës që të zërë vendin e autoriteteve vendëse dhe përcaktojë këto arsye të reja për burgim në mënyrë prapavepruese (shih paragrafin 69 më sipër).

76. Së fundmi, Gjykata vëren se vendimet vendëse të datave 5 dhe 27 nëntor 2013 konstatonin se masat alternative ndaj ndalimit me burg të kërkueses konsideroheshin të papërshtatshme (shih paragrafët 8 dhe 14 më sipër). Megjithatë, përveçse një deklaratë formale se masat e tjera ishin marrë në konsideratë, vendimet vendëse nuk i referoheshin në thelb masën e konsideratës që gjykatat vendëse kishin treguar ndaj masave alternative për të siguruar që kërkuesja do të paraqitej në gjykim (shih *Jablonski kundër Polonisë*, nr. 33492/96, § 83, 21 dhjetor 2000).

ii. Procesi përpara gjykatave të larta

77. Edhe pse shumë prej kërkesave të përmendura më sipër në lidhje me vendosjen e një mase ndalimi tashmë ishin njohur nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë (shih paragrafin 38 më sipër), Gjykata vëren se apelimi i kasacionit të kërkuësës mbështetur në kërkesat e përmendura ishte kundërshtuar nga Gjykata e Lartë me anë të një vendimi *de plano* papranueshmërie.

78. Gjykata Kushtetuese nuk i kishte shqyrtuar argumentet e saj për meritat, duke e kundërshtuar ankesën e saj me arsyet e vetme se ajo nuk ishte mbajtur më tej në burg. Në lidhje me këtë, në një sërë çështjesh të lidhura me rrethana të krahasueshme, Gjykata kishte konstatuar një shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës, duke u mbështetur në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë ku ankimet ishin deklaruar të papranueshme, në rastin kur një vendim i ri, në lidhje me ndalimin me burg të ankuesit ishte miratuar përpara se gjykata të jepte vendimin e saj (shih *Bernobić kundër Kroacisë*, nr. 57180/09, § 93, 21 qershor 2011; *Krnjak kundër Kroacisë*, nr. 11228/10, § 54, 28 qershor 2011; *Šebalj kundër Kroacisë*, nr. 4429/09, § 223, 28 qershor 2011; dhe *Margaretić kundër Kroacisë*, nr. 16115/13, § 119-121, 5 qershor 2014).

79. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kufizimi i së drejtës së kërkuësës për një shqyrtim kushtetues të periudhës së parë të burgimit të saj për mungesë të një interesi legjitim, dhe rëndësie, nuk përcaktohej specifikisht nga ligji vendës. Një kufizim i tillë ishte identifikuar nga Gjykata Kushtetuese në interpretimin e saj të nenit 134 § 2 të Kushtetutës, i cili parashikon se individët që ankohen përpara Gjykatës Kushtetuese duhet të justifikojnë një interes personal në proces (shih paragrafin 27 më sipër).

80. Siç përcaktohet nga Qeveria, pozicioni i Gjykatës për të shqyrtuar pajtueshmërinë me ligjin vendës është i kufizuar, pasi fillimisht u takon autoriteteve vendëse (kryesisht gjykatave) të interpretojnë dhe zbatojnë ligjin vendës (shih, midis autoriteteve të tjera, *Kudrevičius dhe të Tjerët kundër Lituanisë* [DHM], nr. 37553/05, § 110, GJEDNJ 2015, dhe *Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy kundër Finlandës* [DHM], nr. 931/12, § 144, 27 qershor 2017). Në rast se interpretimi nuk është arbitrar apo dukshëm i paarsyeshëm, roli i Gjykatës kufizohet në përcaktimin nëse efektet e atij interpretimi janë në përputhje me Konventën (shih *Radomilja dhe të Tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, § 149, 20 mars 2018, dhe *Qendra për Demokraci dhe Shtetin e së Drejtës kundër Ukrainës*, nr. 10090/16, § 108, 26 mars 2020, me referenca të tjera).

81. Duke u kthyer te rrethanat konkrete, Gjykata nuk është e bindur se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 24 shkurt 2016 apo vërejtjet e Qeverisë përpara Gjykatës përcaktonin bindshëm arsyet për përfundimin se kërkuësja nuk kishte interes personal në kundërshtimin e ligjshmërisë së periudhës së parë të burgimit të saj.

82. Për të arritur në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ishte mbështetur ekskluzivisht në faktin se paraburgimi i kërkuësës ishte ndërprerë. Megjithatë, siç është përmendur tashmë në paragrafët 46–47 më sipër, vendimi i datës 19 qershor 2014, i cili e vendoste kërkuësen në arrest shtëpie nuk përfshinte ndonjë përcaktim të ligjshmërisë për periudhën e parë të paraburgimit të saj.

83. Siç edhe përcaktohet nga gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese me qëndrim kundërshtues, në datën kur Gjykata Kushtetuese miratoi vendimin e saj, kërkuësja kishte vuajtur tashmë privimin e lirisë së saj; në këtë mënyrë, ajo mund të përfitonte në mënyrë legjitime nga një shqyrtim kushtetues *post facto* për periudhën e parë të burgimit të saj (shih paragrafët 19 dhe 45 më sipër). Një shqyrtim i plotë nga Gjykata Kushtetuese mund të kishte çuar në konstatimin se kërkuësja ishte mbajtur në burgim në shkelje të së drejtës së saj për liri. Përveç interesit moral në marrjen e rezultatit, një ndihmë e tillë deklarative mund të hapte rrugën edhe për një kërkesë për kompensim mbi arsyet për burgim të paligjshëm sipas nenit 5 § 5 të Konventës (shih *S.T.S kundër Holandës*, nr. 277/05, § 61, GJEDNJ 2011), një e drejtë që njihet edhe nga ligji vendës (shih paragrafët 34–37 më sipër).

84. Në çdo rast, refuzimi i Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar meritat e ankesës së kërkuësës nënkuptonte se mangësitë në arsyetimin e vendimeve të shkallës së parë dhe të apelit nuk ishin korrigjuar, dhe cenimi i së drejtës së kërkuësës për liri nuk ishte kompensuar as nga shqyrtimi i kasacionit apo atij kushtetues në nivel vendës.

iii. Përfundim

85. Konstatimet e mësipërme janë të mjaftueshme për ta bërë Gjykatën të arrijë në përfundimin se gjykatat vendëse nuk kanë dhënë arsyet e duhura dhe të mjaftueshme për të mbështetur vendimet e tyre, në lidhje me periudhën e parë të burgimit të kërkuases.

86. Për këtë arsye, është shkelur neni 5 § 3 i Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

87. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”.

A. Dëmi

88. Kërkuësja kërkoi 13,626,777.7 lekë (116,658.49 euro (EUR)) për dëmin pasuror dhe jopasuror. Ajo parashitroi një sërë pasqyrash bankare, në lidhje me shpenzimet e bëra nga familja e saj në lidhje me burgimin e saj si edhe një raport nga eksperti ku përcaktohej dëmi i saj moral dhe psikologjik.

89. Qeveria parashitroi se pretendimi ishte i pambështetur në fakte dhe i tepërt.

90. Gjykata nuk gjen ndonjë lidhje rastësore midis shkeljes së konstatuar dhe pretendimit për dëm pasuror. Duke pasur në konsideratë natyrën e shkeljes së konstatuar, Gjykata, duke gjykuar mbi baza të barabarta, i akordon kërkueses 4,500 euro për dëmin jopasuror.

B. Kostot dhe shpenzimet

91. Gjithashtu, kërkuësja kërkoi 5,500 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendëse dhe në Gjykatë. Ajo paraqiti dy fatura prej 2,500 eurosh dhe 3,500 eurosh në mbështetje të kërkesës së saj.

92. Qeveria parashitroi se shumat e pretenduara ishin të tepruara dhe se faturat e dorëzuara nuk ishin paraqitur në formatet e miratuara zyrtarisht për faturat.

93. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkuës ka të drejtën të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet vetëm për atë që është provuar se ato janë bërë faktikisht dhe kanë qenë të nevojshme dhe janë të arsyeshme sipas kuantitetit. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuësja ka ndjekur proceset në katër nivele të gjykatave vendëse përpara se të dorëzonte kërkesën e saj përpara Gjykatës. Në të shkuarën, Gjykata ka kundërshtuar argumentin e Qeverisë, se pretendimet për kostot dhe shpenzimet duhet të mbështeten me fatura të miratuara zyrtarisht (shih *Sharxhi dhe të Tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 10613/16, 11 janar 2018; *Delijorgji*, cituar më sipër, § 100; dhe *Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, § 129; 1 prill 2014). Ajo nuk gjen arsye për të arritur në një përfundim tjetër për këtë çështje.

94. Duke pasur parasysh dokumentet në zotërimin e saj dhe kriteret e mësipërme, Gjykata e konsideron të arsyeshme që të akordojë shumën prej 3,500 eurosh për mbulim të kostove për të gjitha kategoritë, plus taksat që mund t'i tarifohen kërkueses.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. Rrëzoi kërkesën e Qeverisë për ta çregjistruar çështjen nga lista e saj e çështjeve;
2. Deklaroi ankimin në mbështetje të nenit 5 § 3 të Konventës të pranueshëm;
3. Gjykon se është shkelur neni 5 § 3 i Konventës pasi gjykatat vendëse nuk kanë dhënë arsyet e duhura dhe të mjaftueshme për periudhën e parë të burgimit të kërkueses;

4. Vendos:

a) se Shteti përgjegjës duhet t'i paguajë kërkueses, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi është bërë i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që duhet të konvertohen në monedhën e shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e pagesës:

i. 4,500 euro (katër mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet, për dëmin jopasuror;

ii. 3,500 euro (tre mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet për kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i periudhës tremujore përmendur më sipër deri në shlyerje, për shumat e mësipërme do të paguhet interes i thjeshtë në normën e barabartë me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagesës, plus tre për qind pikë.

5. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuar për kompensim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 21 shkurt 2023, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško
SEKRETAR

Pere Pastor Vilanova
KRYETAR